[Shqiptarja.com]

E diel 4 Shtator 2022 - Përditësimi i fundit 19:53

Zgjidhja e **fiskalizimit** po ju lë pa punë dhe pa gjumë?
Kaloni në devPOS
dhe mos paguani asgjë për periudhën e mbetur të kontratës suaj aktuale!

POP 5 Lajmet më të lexuara të 5 minutave të fundit

1

I zhdukur prej 2 ditësh, biznesmeni shqiptar gjendet i vdekur në Itali (Emri)

2

Peshëngritësja Veli me doping, Pirro Dhima i përgjigjet Kreut të Federatës Shqiptare të Peshëngritjes: S'kemi nevojë për të, do shihemi në gjyq! Shqiptarët më trajtojnë si tradhtar

3

Gjermani/ Goditi me sëpatë një 27-vjeçare ukrainase! Autori shqiptar qëllohet për vdekje nga policia

4

(FOTOT) Vrasja e dyfishtë në Tiranë, dalin pamje nga sherret mes vëllezërve Muskurti! Përplasen me grushta në market, dy persona i ndajnë

5

Lufta në Ukrainë/ Moska kërcënon SHBA: Tani je pjesë e konfliktit! Ja përgjigja e Rusisë ndaj Nord Stream

Kronikë

Vritet në Shkodër Ismet Çekorja, i biri në kërkim për atentatin ndaj Bruçit! Viktima e paralajmëroi 4 ditë më parë: Familjes sime i janë qepur shteti e bandat! (VIDEO)

Ekzekutohet me 7 plumba, shumë pranë shtëpisë, Ismet Çekorja. Viktima është babai i Bajram Çekorjas, i shpallur në kërkim ai autor atentatit ndaj Alban Bruçit, në 25 gusht. 4 ditë më parë, 57-vjeçari foli për mediat, ku kërkonte drejtësi për të birin, teksa tha se familjes së tij i janë vënë pas bandat dhe shteti.

- Bajram Çekorja, i arrestuar në 2019 si pjesë e grupit 'Lici'
- Video e deklaratës së fundit të viktimës: Familjes sime i është qepur shteti dhe bandat

Redaksia
2 Shtator, 14:59 | **Përditesimi: 2 Shtator, 17:23**

SHKODËR- ***4 ditë më parë*** doli në media për të kërkuar drejtësi për djalin që i është akuzuar për vrasje, sot, Ismet Çekorja është ekzekutuar me breshëri plumbash. Gazetari i Report Tv, Ergys Kavaja raporton se ngjarja ka ndodhur rreth orës 15:00, në lagjen "Guerrile", në Shkodër, shumë pak metra larg shtëpisë së tij. Autori/ët kanë qëlluar 7 herë me pistoletë ndaj Çekorjas dhe më pas janë larguar me shpejtësi nga vendi i ngjarjes. 57-vjeçari është dërguar me urgjencë në spital me shenja jete, por për fat të keq nuk ia ka dalë t'i mbijetonte plagëve të marra. Në momentin e vrasjes mendohet se ka pasur edhe persona të tjerë të cilët janë shoqëruar nga policia e Shkodrës, ndërkohë janë sekuestruar edhe kamerat e sigurisë të cilët mund të zbardhin detaje ose mund të shërbejnë për grupin hetimor që të bien në gjurmët e autorëve.

KPGJT
KOLEGJI PROFESIONAL I LARTË GJERMAN I TEKNOLOGJISË

Nje det me oferta te pret...
zbulo me teper ne booking.adriaferries.com
AF adria ferries
...una scia di emozioni!

Kush është Ismet Çekorja?
Ismet Çekorja është babai i Bajrman Çekorjas. Ky i fundit është shpallur në kërkim, si autor i dyshuar i atentati të dyshuar ndaj Alban Bruçit të ndodhur në 25 gusht. 4 ditë më parë, Ismet Çekorja doli në një deklaratë për mediat, ku tha se familjes së tij i janë qepur shteti dhe bandat të veshura me pushtet.

LEXO EDHE:
Dasmë në Shkodër për të ndihmuar fëmijë me aftësi ndryshe! Aheng dhe jare shkodrane në oborrin e muzeut 'Oso Kuka'

Si ndodhi atentati ndaj Alban Bruçit, i përfshirë djali i viktimës?
Në 25 gusht, rreth orën 21:45, Alban Bruçi po lëvizte me makinën e tij tip 'Audi A3', me targa 'AB 199 BA, kur u qëllua disa herë me pistoletë. Fatmirësisht plumbat nuk e kanë kapui, duke i shpëtuar për mrekulli kësaj tentative për ta ekzekutuar. Si autor të kësaj ngjarjeje, janë shpallur në kërkim, ***Bajram Çekorja***, (djali i viktimës, Ismet Çekorja) dhe Tornato Fusha, djali i biznesmenit dhe ish-presidentit të Vllaznisë Valter Fushës. Nga sa është raportuar, ka qenë sherri i ndodhur 2 vite më parë mes Fushës dhe Bruçi shkak i tentativës së atentatit të 25 gushti, teksa nuk dihet roli që ka pasur Çekorja. Bajram Çekorja ka me precendentë penalë. I arrestuar në 2016 për tenativë vrasje si dhe i arrestuar në 2019 te 'Komuna e Parisit', ***si pjesë e grupit "Lici"***.

Pista kryesore e hetimeve për ekzekutimin e sotëm të Ismet Çekorjas lidhet pikërisht me këtë ngjarje, ku është përfshirë djali i tij.

Shqiptarja.com

\

Viktima Ismet Cekorja

Rendit zhvillimet sipas orarit: Të Fundit

Ora 15:38

Sot iu vra babai, kush është Bajram Çekorja i akuzuar për atentatin e dështuar në 25 gusht në Shkodër! Vrasja dyshohet për hakmarrje



Ditën e sotme u ekzekutua në Shkodër, Ismet Çekorja është babai i ***Bajram Çekorja***. Ky i fundit është një nga të akuzuarit kryesor për atentatin ndaj ***Alban Bruçit*** të ndodhur në 25 gusht. Bajram Çekorja është shpallur në kërkim, së bashku me Tonato Fusha, 20-vjeç djali i biznesmenit dhe ish-presidentit të Vllaznisë Valter Fushës.

Ora 15:32

‘Familjes sime i është qepur shteti dhe bandat në shpinë’ çfarë tha 4 ditë më parë Ismet Çekorja, i ekzekutuar sot afër shtëpisë në Kiras të Shkodrës

4 ditë më parë, Ismet Çekorja, sot i ekzekutuar, doli në një deklaratë për mediat ku i doli në mbrojtje djalit që ishte shpallur në kërkim, Bajrami duke thënë se nuk kishte lidhje me atentatin ndaj Alban Bruçit të ndodhur në 25 gusht. Ai thoshte se familja e tij po sulmohej nga një grup banditësh të lidhur me njerëz me pushtet.

> *"Policia ka ardhur në banesën tonë pas vrasjes së Arjan Ferracakut një kohë që viktima ishte nipi im po ashtu kur u vra edhe Fatos Ferracaku prap më kanë thirrur mua dhe djalin. Pastaj janë vrarë vëllezërit Bilali dhe sërish policia në banesën time një kohë që kemi kaq shumë vite që jemi fqinj. U plagos Admir Bajri, prap në banesën time një kohë që familja jonë e ka patur një lloj njohje me familjen e tyre. Po ashtu u qëllua shefi i policisë bashkiake të Malësisë së Madhe sërish në banesën time kur në fakt autorët dolën krejt persona të tjerë. Rasti i fundit është me Alban Bruçin, djalin e Lad Bruçit të cilin unë e kam shumë mik dhe nuk ka asnjë shans që djali im të qëllojë djalin e tij kur ne kemi shumë miqësi aq më tepër që Bajrami, djali im është i monitoruar me kamera.*
>
> *Këto sulme ndaj familjes tonë i bëjnë disa bandit, hajdutë biçikletash dhe banditë të veshur me pushtet. Se cila është arsyeja ne nuk e dimë. Ajo që kërkojmë është drejtësia. Djali im është i pafajshëm dhe nuk ka marrë pjesë në asnjë prej ngjarjeve kriminale për të cilat është i dyshuar. Janë të gjithë inskenime dhe tani ai duhet të qëndrojë rrugash dhe nuk mundet as të punojë as asgjë. Kërkojmë drejtësi dhe të zbardhen ngjarjet" , është shprehur Ismet Çekorja, 3 ditë para se të ekzekutohej.*

Ora 15:23

Pak ditë më parë doli në deklaratë për mediat për të mbrojtur djalin në

kërkim, kush është viktima e atentatit të sotëm në Kiras të Shkodrës

Report Tv mëson se viktimë e atentatit të sotëm është Ismet Cekorja. Pak ditë më parë, ai doli në një deklaratë për mediat, ku tha se djali i tij Bajrami nuk kishte lidhje me atentatin ndaj Alban Bruçit të ndodhur në 25 gusht.

K.T./B.K./Shqiptarja.com

TAG: ismet cekorja · Shkoder · Ekzekutimi i Ismet Çekorjas · Bajram Çekorja · tornato fusha

Komento

Komente

kiraskiras: 04/09/2022 17:24

Ismet nuk e ke luajt mirë pjesën që të kishte caktu regjizor Mustafa! Përballë kamerave duhet të ishe ma trim që hasmi të kishte frikë dhe duhet të bajshe ma shumë me gishtin nalt, duke e tundur fort! Skena ca të bajm. Qofsh i xhenetit.

Përgjigju

Jek: 03/09/2022 22:27

Ka vu boksijeri kamra ne krejt zoteknik

Përgjigju

> **Sepse:** 04/09/2022 16:26
>
> Jeton kiras sepse aty ka kuajt e titit

> **Pse:** 04/09/2022 09:59
>
> Boksieri jeton ne kiras hala me gjith ato probleme qe ka me lict, apo ne dobrac ku mund te jet shum here me i sigurt? Aty ne kiras mund te vritet shum kollaj

Leona: 03/09/2022 22:26

Kan pas akses se ka vu boskieri kamrra ne tan zoteknik

Përgjigju

Astriti: 03/09/2022 22:26

Kamerat i kan pa prej te shpia e halls asmerit si jan vra titi e baqi 10 meter ma larg

Përgjigju

> **Astrit qorri:** 03/09/2022 22:31
>
> Shko o bos futja naj teke raki ma mir

mesazh: 03/09/2022 20:16

edhe ktyne laperave tyne pastrusave t baglave ka me ju vra ibrahimi qe mbshtesin ato tesh e mrapa keni me pa terror me sy kyt po ju tham une mendim personal tu e njoft at djalin si asht tesh S.Xh, E.H e kompani e ato tik tokersat t gjejn bir ku mu fut ose te marrin azilet ma mir se kan me pas perfundimin ma tkeq te mundshem edhe ato vrasesit e endrit e kush a inpleku n vrasje i din shum mir kush jan aj djali tesh situata asht teper e rand ne shkoder se kan dasht me ngacmu luanin qakejt tesh shifni terror me sy

Përgjigju

> **kirasi:** 04/09/2022 19:09
>
> ismetin dihet kush e vravi pa dyshim qe lict bashk me bajramin kan mi llan pergjigje por mos flitni pa lidhje demek me fut njerz ne sherr njerz qe noshta inkeni inad aj e.h ska lidhje me vrasjen aj a shoqnu ne polici me njerzt e vet aj tjetri s.xh aj a mu kap me shputa jo pr pushk as nk vritet as ska ***me vra kend

> **O sms:** 04/09/2022 17:17
>
> Ibrahimi ta kap mamin me zor po mos fol shum ok

> **sms:** 04/09/2022 14:58
>
> Kush asht luani ? Ibrahimi si hu modhatartash i thu ti luan ?! Mos mor mik mos

Shaban Shaulliç: 03/09/2022 09:34

Kanë vra burrin ma t'mirë n'Shkoder

Përgjigju

> **po shaban po:** 03/09/2022 14:24
>
> Zotnikarburr ka ken , ai thjesht u vetvra !

> **Zigzaku:** 03/09/2022 11:24
>
> Mos den me i shku afer edhe ti

RRESPEKTE: 03/09/2022 00:11

KTO NE SHKODER JAN HISTORI HASMERIE DHE ASKUSH PREJ TYNE NUK KA LIDHJE TE FORTA JASHT SHTETI. KURSE GRUPI ME I FUQISHEM ME DJEM TE RRINJ PO TE GJITH NGA SHKODRA I KE NE GJERMANI (MUNCHEN, HAMBURG)DHE AUSTRI ZVICER ME LIDHJE NE AMERIKEN E JUGUT DHE KAN LIDHJE MIQESORE ME NJE FAMILIE NGA ISRAELI QE I KA MBESHTET GJITHMON EDHE BEJN VRASJE PO JU PRISHE INTERESAT TE KESH TI EDHE 50 QUNA XHAJE TE VRASIN KUDO NEPER BOT EDHE NUK KAN SHKELUR POTHUJSE KUR NE SHQIPERI NUK I INTERESON OSE ME SAKT SHUM PAK HERE NUMEROHEN ME DIT , JAN SHUM ME LEK DHE TE FUQISHEM NUK KRAHASOHEN ME ASNJI NGA KTO GRUPE QE RIN TE NGUJUARA DHE SDIN QA ESHT EUROPA DHE BOTA RRESPEKT PER SHKODRA MAFIA ATO JAN TE SHKATHET

Përgjigju

@ rrespekte: 03/09/2022 14:47

familja prej gjakovet? E ke fjalen per vllaznit osmani mo?

Pergjigje: 03/09/2022 14:25

Jan djem te rrij dhe jan le e rit atje, ne gjermani holland spanje se asmje problem me investu leket dhe smeren hiq me investime ne shqiperi sepse investime ne shqiperi i ben naj nji nga mali ose katunar qe i duket vedja se ka bo lek. Imagjino qe as emrin nuk u jan permend por shqiptaret qe jetojn jasht kan nigjur per to por dhe jo aq shum sepse jan shum ne hije e pamundur per ti takuar dhe pir kafe me to jan si ajo familia nga gjakova ne gjermani por diferenca me ato esht qe nuk i nihet zeri

Shkoder: 03/09/2022 11:36

Po kush jan kta o vlla na i thuj ? Se shumica ca merren jashte vijn e investojn ktu se a ma lehte e atje ske si i deklaron

Berati: 02/09/2022 23:41

O te pa bese edhe burracak vritet ai qe ka vrarë, me familjaret skeni pune se nuk eshte burrni.Ku keni ndermend te shkoni do ktheheni te epoka e gurit me keto vrasje jave me jave ju q jeten qe beni jete urdhi me vrane sot me vrane neser jet leshi ben te fortet e k . Jeni ndare ne grupe si ne kohen e qepes

Përgjigju

Tomka Dhe dashnoret e tija: 02/09/2022 22:51

identik si dikur qe kena pas lujt lagje per lagje "pam Pam" pushken e kam te xhamia rusit jam hahaha

Përgjigju

Tan dragani: 02/09/2022 22:31

Ju du fort te tanve jeni mreten te tan .

Përgjigju

Tan dragani: 03/09/2022 13:29

Qa intrigash kam ba un ma dushe ? Un jam i mir rri npun teme , shof a ka kun naj dreke qyl a naj shishe te madi qyl . Ju hangsha zemren ju mos u bani me nerva me vllaun tuj

Kuku isuf: 03/09/2022 06:09

Edhe na te dona ty ma ar

O tan: 02/09/2022 23:35

Ke ba do intriga dhe ti , si nuk u kujtu kush me ta leshu nji breshni dhe ty

per kazanin e dobraqit: 02/09/2022 22:02

kazani i dobraqit shum shpejt do perjetoj terror me sy shum shpejt ashtu siq jan tu perjetu as ne varrim te naimit skan shku e ka varros komunalja naimin kurse at gjysmakun admirin nuk kan shku ne spital me e pa kto “trimat e shkodres” qe kan mendu se do marrin shkodren para po ju kan dal llogarit gabim vran bardhin per emer per asgja tjeter se licajt nuk kishin pun me to por tesh lict i kan vesh kpuct mir e nuk ka ma kthim mbrapsht se per bajrat miliona euro hedhin me mbyll punt me lict kurse aj kalorsi i ka hyp kalit mbrapsht me vite e ka marr rreston e tij dhe do e marri prep

Përgjigju

luani: 04/09/2022 17:08

qa morra vesht kan nxerr grat me nxerr pushk n oborr se kan kujtu se ju ka ardh sallaksi hahahahahahahahahaha o me lot kto jan trimat praaa

per komentuesin: 04/09/2022 17:05

ke fol tdrejt ktu ibrahimi kam nigju ju del ne anderr

Ambasadori: 03/09/2022 14:27

dhe ne rubriken e tij ka vec numra kirasjan !

kirasjan: 02/09/2022 23:19

qa dmth kur ke pas lek tmadh..edhe pre nvorr shkrun bardhok plani pidhi sams

per ushtin: 02/09/2022 23:13

o ushti per me ju rrujt ju rruhet boll se nja 3 veta ju kan qu lict per stan golem e 1 ju kan lan gjys njirit hahahhahahahahahahhaha

Kirzs: 02/09/2022 23:04

Boksjeri ka ba dhe fmi tesh

Far west: 02/09/2022 22:57

A jena per naj loj ne play station o zogu kirasit

Bardhok Plani: 02/09/2022 22:39

nipqe mos u ban me nerva se ta prenen bileten dhe ty njashtu si mu

Or djal: 02/09/2022 22:37

Ca miljonash kan ata para sokolit edhe lulit mor je n terezi ti apo jo osht si me krahasu mizen me kalin , mos them kan mshum lek se cdo kush n shkoder

Ushttttt: 02/09/2022 22:35

Hahahahahaahahahahahahahahahahahaha Banu edhe ti me lict se nuk i rruhet kuj o lepurush me vesh te shkurt

kiras: 02/09/2022 22:24

paske fol fjal me vend ati boksjerit ja kan tha zemren aj jeton kot tash qe vravi ismetin aj se din ca i ka ba vedit kan me e perdhunu ne pluma lict kan me ja masakru tan ca njerz pleq e djem te ri

Per bishpllumat e 2022: 02/09/2022 21:59

o bishtpllumat e kirasit mos mendoni se baheni trima vecse leni bishtin mas kreje o lepurusha ahahah.....

Përgjigju

Lezha: 02/09/2022 21:59

Eh mor djal fute ne dhe baben se don me u perzi kot me pislleqe. A ka ma hall mos me mujt me fut baben ne dheeee teshhhhhh ???? Baba neser hyn ne dhe e ti sje se ne kerkim

Përgjigju

Lezha: 02/09/2022 22:24

o gjujtsi ha ha ha , ik o kingu mos u perzij ne kto pune se do te qaje dhe nana jote pastaj .

per lezhen: 02/09/2022 22:11

te Allahut jena te Allahu kena mu kthy po vec ta dini keni vra nji plak qe si ka pas borgj askujt e ta dini se keni me hanger pluma turive ku sju prejt mendja

Shtet pa shtet: 02/09/2022 21:56

Ne cfare vendi jetojme.Del personi me ze dhe figure dhe thote po me rrezikohet jeta per faj te djalit dhe ky palo shtet as do te dije per njerezit e vet.Vend plehre jemi ku jeta vlen 2 lek.Me mire pa shtet edhe e dime qe kemi bandwt sesa me kte shtet te korruptuar.te mbaruar.te degjeneruar. Nese ka vrare djali i ktij rahmetit hakat ti laj vet me koken e vet.cfaj ka babai.

Përgjigju

Rozafa sea food: 02/09/2022 21:55

Rrallen e ka sarreqi , sa thu i ka shku koficenti ? A din kush gja ?

Përgjigju

Nardi: 03/09/2022 14:02

Vec na trego peshen e tij se masanej e gjejm vet kush asht

Nardi: 03/09/2022 13:55

Vec na thuj sa kile asht se masanej e gjejm vete

nardi: 03/09/2022 13:54

Vec na e thuj sa kile asht sepse e gjejm vete masanej

Padova: 03/09/2022 13:53

a thu mos i ka ardh rralla atij Kristjanit ragos ? Se nuk ti fal kush gabimet qe ke ba mor amico

Likja001: 03/09/2022 13:36

ne sarreq vec intriganta kan nejt tan jeten , shum gjate ju ka shku pa i sharru nja 2-3 aty , sepse mir konjokturat e vjetra qe e kan ne gjak intrigen , por jan ba dhe kto filizat e rinj me lek dhe kan fillu me ba intriga dhe pabesina . mendojne se nuk merren vesht gjanat shkoder !

bet 365: 03/09/2022 13:32

U dashka me e lujt si skedine te brryli

Tam hoxha: 03/09/2022 13:20

Naj nji i pabese do jete !

Nomo: 03/09/2022 00:45

Kush a sarreqi

Rusi: 02/09/2022 23:34

kush asht sarreqi?! a din kush me 3gu ?

Rozafa sea food: 02/09/2022 23:07

surprize ! vec ishalla nuk shkon 3+ se gjynah

@Don pietro: 02/09/2022 23:05

Per cilin sarreqas e keni fjalen ??????? A eshte i forte ky ??

per rozafa sea food: 02/09/2022 22:36

kush asht ky prej sarreqit?

sherbimi funeral sarreq: 02/09/2022 22:30

O rozafa o llomi sarreqit rri shif punt tuja se nuk te pyt kush sot se kush tvjen mrapa , neve te sarreqit na e rrujn me gillette 3

Don pietro: 02/09/2022 22:06

Koficenti 1.01 !

Sa për kujtesë ....: 02/09/2022 20:48

Një person me precedent të theksuar kriminal në fushën e narkotikëve është arrestuar nga Policia e Shkodrës. Uniformat blu kanë vënë në pranga edhe bashkëpunëtorin e tij si dhe është proceduar në gjendje të lirë një tjetër, për mbajtje pa leje të armëve të ftohta. Janë arrestuar shtetasit Bajram Çekorja 22 vjeç dhe Ilirjan Skuqaj 25 vjeç banues në lagjen Guerrile, Shkodër, për veprën penale "Prodhimi dhe shitja narkotikëve" e kryer në bashkëpunim. Gjithashtu është proceduar penalisht në gjendje të lirë shtetasin I. Ç. (babai i shtetasit Bajram Çekorja). Policia njofton se arrestimi këtyre shtetasve u bë pasi gjatë kontrollit të ushtruar në banesën e shtetasit I. Ç., u gjetën 277 doza me lëndë narkotike cannabis sativa. Njoftimi i policisë Vihet në pranga një person me precedent kriminal të theksuar në fushën e narkotikëve dhe krimeve ndaj personit. Arrestohet edhe bashkëpunëtori i tij, si dhe procedohet në gjendje të lirë një tjetër, për mbajtje pa leje të armëve të ftohta. Sekuestrohet një sasi lënde narkotike e bërë gati për shitje. Strukturat e DVP Shkodër, në bashkëpunim me Komisariatin e Policisë Shkodër, në zbatim të planit të masave për goditjen e paligjshmërisë dhe në bazë të informacioneve të marra në rrugë operative për një person me rrezikshmëri shoqërore që merrej me shpërndarje të lëndëve narkotike në doza të vogla, kanë organizuar punën dhe si rezultat kanë kapur e vënë në pranga shtetasit: – B. Ç. 22 vjeç, banues në lagjen Guerrile, Shkodër dhe I. S. 25 vjeç, banues në lagjen Guerrile, Shkodër, për veprën penale "Prodhimi dhe shitja narkotikëve" e kryer në bashkëpunim. Gjithashtu kanë proceduar penalisht në gjendje të lirë shtetasin I. Ç. (babai i shtetasit B. Ç.). Arrestimi këtyre shtetasve u bë pasi gjatë kontrollit të ushtruar në banesën e shtetasit I. Ç., u gjetën 277 doza me lëndë narkotike cannabis sativa. Gjithashtu, gjatë kontrollit në banesën e shtetasit I. Ç. 55 vjeç, banues ne lagjen Guerrile, Shkodër, u gjet një thikë me dorezë metalike. Materialet iu referuan Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër, për veprime të mëtejshme.

Përgjigju

Andi: 02/09/2022 20:27

Po ca keni qe mereni me kete te shkretin qe vdiç lereni ti prehet shpirti ne paqe.

Përgjigju

Dikush: 02/09/2022 19:46

LLOJ LLOJ KOMENTESH SIKUR JENI NE EPOKEN E GURIT KY KISHTE FAJ E AI TJETRI KISHTE FAJ , MBLIDHNI MENDJEN SE KINI IK PER LESH TE GJITH ,KINI FEMIJ I EDUKONI SI DUHET SE MARRIN RRUGEN E MUTIT ATE BONI LINI KETO IDJOTLLIQE VRITEN NJEREZ NGA KRIMINELET SHKODRA ME ARDHJEN E DEMOKRACIS IKU NGA FIQIRI , DHE GJITH SHQIPERIA U CELEN GRUPET KRIMINALE ,FILLOI QE ME VRASJEN E ARBEN BROXIT SE DO JU ZINTE KOLLTUKUN , DIKUR SHKODRA NDRYSHE SOT QYTET ME KRIMINELA , PO KESHTU EDHE NE QYTETET E TJERA, PO MBANI FEMUJET MOS I LINI TE IKI SI KY E SI TE TJER ATE BONI I LINI KOMENTET PREJ INJORANTESH.

Përgjigju

NUK SHAHET NJERIU KOT: 02/09/2022 19:20

NUK DILET DHE OFENDON NJEREZ SHKODRAN NEPER TELEVIZOR KOT SE KOTI, DEMEK JAM TRIM TE ERDHI PERGJIGJA E SHKODRANVE MRENA 24 OREVE TASH SHOFIM A DO QITNI PUSHK PO JU MAJTI. SHKODRANT SPYSIN PER KERKAN PRANDAJ MOS OFENDONI KOT KUR SKENI LEK ME JA DAL BALL OSE NJEREZ KALLABLLEK

Përgjigju

Mendimi: 02/09/2022 19:30

Po dhe kta me kallaballek po I shofim goxha

Adi: 02/09/2022 19:16

Djalin i shkreti, e paska patur vrases me pagese.

Përgjigju

Lor: 02/09/2022 19:06

Dhe forcat shqiponja bejn show ter naten ne tiran ah pika qe si bie ksaj policie

Përgjigju

Piku: 02/09/2022 19:05

Qeveria e le qellimisht Shkodren ne kete derexhe, qe te fitoje vota ngaqe e ka bashjine e djathta. Pfff

Përgjigju

AltinTop: 02/09/2022 18:04

Aq e rende eshte situata ne shkoder sa vete deshtimi i kesaj qeverie 10 vjeçare qe vetem shtet nuk beri kurre.

Përgjigju

AltinTop: 02/09/2022 20:29

"Anonim"- Ne kohen e saliut nuk kisht shtet fare fare... Prandaj perfunduam ketu...nuk doli nje burre shteti ta beje me mire se Saliu..

Anonim: 02/09/2022 19:37

JU SMBUSHNI PSE BABA E RIT FEMIJEN KRIMINEL E KA FAJIN QEVERIA , PSE NE KIHEN E SALI SHPELLARIT NUK U VRAN NE SHKODER , PRINDI ESHT AI QE EDUKON FEMIJEN JO SI AI PRESIDENTI I VLLAZNIS QE DJALI MAKIN 50 MIJ EURO DHE QE BABA MERE PISTOLETEN BIR DHE HAPU BYTHESH SE TE KA BABA CUN .

kiras: 02/09/2022 17:37

ishtu asht kur klyshin e kan lan mu rrit tesh qohet e vret njerz te pafajshem a dasht me i fut plumin kaher kalorsit

Përgjigju

kiras: 02/09/2022 20:11

serial ma tbukur se te vlleznit bilali skam pa najher hahahaha

Hahaha: 02/09/2022 19:02

Hahaha hajt se nuk ka maru seriali hala mos u mrz ti

kiras: 02/09/2022 18:58

pluma bythes po ha ti se po te djeg do tjesh naj legen i ati kalorsit

Per kirasin: 02/09/2022 17:50

Rri rahat mos ha mut se po ha naj plum bythes kot trima fallco

bledar: 02/09/2022 17:34

veq ibrahim lici ju vjen hakut ktyne cubave qe vrasin njerz te pafajshem

Përgjigju

Shkodran: 02/09/2022 17:50

Per ibrahimin sukses esht te vrasi nanji me faj se pa faj kan qen t gjith ata qe kan vra qe te naimi qe te vllezrit bilali qe te arjani borani me gjith nuse kush kan qen me faj nga kta ska arrit dot tjeter kend edhe ju ka ra ktyne

Gjynaf: 02/09/2022 17:13

Atyne që sju kishe frik, ata të kputën. Ngushellime familjes

Përgjigju

BENI ECEN VEHTE: 02/09/2022 16:27

VRAU VETVEHTEN

Përgjigju

Kafja: 02/09/2022 17:37

Si shkon e flet me ate gjuh ne tv, e ben ai tjetri po eshte kaliber i rende, gabim behej rruge pastaj

Taulant: 02/09/2022 16:27

Kam vene re dicka kur ndodhin ngjarje kriminale ne Shkoder, shkodranet vdesin te komentojne ngjarjet si dikur shqiptaret para viteve 2000 dhe secili ne perkrahje te njerit apo tjetrit grup kriminal. Ndersa ne qyetetet e tjera apo ne Tirane ndodhin ngjarje edhe me te renda kriminale ku vriten koka te verteta krimi dhe komentet jane tejet racionale. Sado i keq te kete qene viktima, keqardhje per fatin e tij.

Përgjigju

Danoci: 02/09/2022 23:55

Popull legen,p....meshkuj ,qe e kon menjen me shit pordh,me kap grat e njoni-tjetrit ene me u vra ,sa desha me e bo ene un nji koment te till o taulonto ,I ka miksu malazezi I ka ba mo keq se sllavt

E verteta: 02/09/2022 17:01

Kto komentet ktu sjedhin viktima duhet te bllokohen

Kasemi: 02/09/2022 16:14

Ja mort hakun naimit bravo tash qa doni me ba edhe i fis ma shum ne hasmeri o enver

Përgjigju

Tpast axha enver ty mor nipqe: 02/09/2022 21:54

Hahaha duroni se dhe pak dola

O enver: 02/09/2022 17:18

Ke me pa shpejt sa te eger jena

ENVERI: 02/09/2022 16:35

I kena ba llogarite mor kasem mos u ban marak ti per at pune hiq . Por dicka po du me te pyt ty : pse e cilson qe e morem hakun e Naimit dhe pastaj thu qe dhe 1 fis tjeter ne hasmeri ?nqs merr hakun i bjen te jesh 1-1 apo ju te kirasit jeni te eger dhe nuk ecni me matematike

Turi: 02/09/2022 16:03

Trima thotë dikush të vrasin e të presin , po harroni një gjë më të rëndësishmen nëse vret do të vrasin sado i fortë të jesh do dal dikush më i fortë nga ty prandaj mos merni jetë njerëzish se për koke e keni të gjithë

Përgjigju

Iksi: 02/09/2022 15:52

Or ca jeni tu thon kta kan probleme mes veti bajrajt edhe lict kan problem mes veti kta jan zen grusht njani me tjetrin para ca vitesh edhe sot ka shku puna te armet ca lidhje ka braqja behari e njani e tjetri

Përgjigju

Ik he k...: 02/09/2022 16:00

Se zdike ne cil bot je po lexo mir

Kojshia: 02/09/2022 15:46

Ky zotnia vet e thej rregullat e etikes , doli tu ofendu persona qe kan dhan prova qe te fusin kokrren pa u mendu dy here .

Përgjigju

Kirasi: 02/09/2022 15:43

He mo ismet se the nuk kam frig ken dal perdit the ! Ti ke shpin ne vendin ma te gabum je krejt i kollajt me u vra . Asht dasht me u msheh mir jo me dal me ba si trim ne televizor skam frig ken . Pac rahmet

Përgjigju

sako: 02/09/2022 15:40

ikni nga shqiperia, ka mbaruar cdo gje ikni sa me pare se jeta ska anje vlere

Përgjigju

K.k: 02/09/2022 15:44

Te gjith duam te ikim po ku te ikim.ku te mbytemi kur sna perkrah asnje jashte. Sdo fleme poshte urave me pleq w femije

Paw: 02/09/2022 15:34

Qoft i xhehnetit po ka ik pa pik faji veq prej se asht miq shpie me familjen e gabume shofim cfar reagimi do baje sokoli e braqja

Përgjigju

Plaku: 02/09/2022 15:43

Aj se edhe ky ska ken pa gja i ka fut hund vend e pa vend ku nuk i ka taku se kot nuk te vret kush

Los Zetas: 02/09/2022 15:32

Ka me nis lufta tash me vra Bajrat qe bashk me Nokajt qe jan ma legenat e Lezhes mbeshteten Ervis Martinin. Mire se Bajrat kane vertetu se din me qit po kta fmijacat pedera te Nokajve cka dun me ba?

Përgjigju

per Lezhjani: 03/09/2022 05:12

Dukagjinsi B.P. e vllau i vet D.P. nuk kane pase hak as hile. Fush Krujsit u kane tha me cua nje mesazh qe se kena vra na S.N. Si shume ini fut ne gjak, me F Krujen, do Durrsake, Leksin e Druve, Pllanajt etj. A doni me u nry mren tane jeten?

D.D: 02/09/2022 17:01

B.P ska lidhje me kto fare

O lezhjan: 02/09/2022 16:50

Ai P.B qe permen ti skish asnje lidhje me muabetin e tyne vetem ju kish cu fjal nga ata qe dyshoshin, po te zotet e punes skishin ci boshin gomarit i ran samarit

Kojshia - per kojshiun: 02/09/2022 16:29

shko iher ne dobraq shife at pune a jane aty apo jo hahaha , leni prrallat mor lepur kopshtit

Kojshiu: 02/09/2022 16:03

Po mi kojshie po I ka bo braqja me kolen bajret mos te rin me as ne dobraq me prova e fakte jo llafe I ka vesh nebilina

Lezhjani: 02/09/2022 16:00

Ne nga Lezha thuajme se punet e mira behen dalengadale. Siç iku ai babloku i shkodres B.P. do ju vij dita edhe te tjereve. reagimi nga lezha do te jet aq i madh sa do te mbahet mend gjate

Nga kojshia -Per los cogliones: 02/09/2022 15:44

O jari banu dhe ti sokolin e braqe di ferron dhe banju g*ore ne grup bajrave

...: 02/09/2022 15:43

Po cpun ka ervis martini me kte. Mo fol ne ajer kot

© Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës:
Si e vlerësoni vendimin e qeverisë për të nisur një operacion kundër lidhjeve të paligjshme të energjisë?

Të drejtë | Të gabuar | Nuk e di

Lajme të tjera

Sport

Babë e bir fitues në garën e 'Thriathlon' në Shkodër: Merruni me sport! Aktiviteti ndihmon turizmin

4 Shtator, 13:38

Kultura



Shifrat/ Mbi 60 mijë vizitorë në Kalanë e Rozafës në vetëm 8 muajt e parë të këtij viti

4 Shtator, 12:10

Kronikë

Qarkullonin me pistoleta në makinë, dy në Fushë Krujë e një në Shkodër në pranga

4 Shtator, 10:29

Kronikë

Ekzekutimi i Ismet Çekores në Shkodër, përjashtohet pista e hakmarrjes nga Alban Bruçi! Në hetim aktiviteti i mëparshëm i viktimës dhe djalit të tij

Ergys Kavaja

4 Shtator, 09:46

Kronikë

Vrasja e Ismet Çekores në Shkodër, kamerat kapën autorin me motor! Shoqërohet Alban Bruçi, ndaj tij dyshohet se qëlloi djali i viktimës

3 Shtator, 10:30

Reportazh

Shiroka e fëmijëve, e 'gjarpërinjve që pinë ujë në liqen' dhe 'a ke punë me kënd?'

Anila Prifti

2 Shtator, 20:08

Kronikë

Shpallen në kërkim 2 vëllezër në Vaun e Dejës! Goditën 28-vjeçarin në kokë me tytën e çiftes

1 Shtator, 14:57

Të shtëna me armë zjarri në Malësi të Madhe, qëllohet me breshëri plumbash drejt një banese

31 Gusht, 15:09

Kronikë

Akuzohen për abuzim me tenderin për rikonstruksionin e Komisariatit në Shkodër, Gjykata e Apelit liron 7 policët, me tyre Saimir Rustemi

Ergys Kavaja

30 Gusht, 12:17

Kronikë

Atentati i dështuar në Shkodër/ Flet babai i autorit të dyshuar: Kam video, djali s'ka lidhje! (Kontradikta me pamjet që i hedh poshtë alibinë)

29 Gusht, 14:03

Kronikë

Aksident i rëndë në Shkodër, mjeti përplaset me murin dhe kthehet përmbys në mes të rrugës (VIDEO)

28 Gusht, 19:36

Kronikë

Tentuan të trafikonin kanabis, kateminë dhe ekstazi drejt Malit të Zi, arrestohen 4 persona në pikën kufitare të Muriqanit (EMRAT)

28 Gusht, 10:50

© 2011 - 2022 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje